

Buletini

Prill 2016

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Aktivitetet Tjera

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Pengim posedimi dhe mbrojtja gjyqësore nga akti i pengim posedimit

Më 01 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Pengim posedimi dhe mbrojtja gjyqësore nga akti i pengim posedimit”.

Në fokus të trajnimit ishte elaborimi i pengim posedimit dhe llojeve të tij, elementet e aktit të pengim posedimit, procedura në kontestet e pengim posedimit, mbrojtja gjyqësore nga akti i pengim posedimit etj.

Në kuadër të trajnimit u trajtua edhe natyra e posedimit, fitimi dhe humbja e posedimit, mbrojtja e posedimit si dhe

afatet për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit.

Trajnimi u zhvillua përmes diskutimeve të pjesëmarrësve për dallimin në mes të pushtetit juridik dhe faktik mbi sendet, përkufizimin e elementeve të pengim posedimit, zbatimin e drejtë të procedurave për mbrojtje nga pengim posedimi dhe specifikat tjera të kontesteve të tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe bashkëpunëtor profesional vendor të nivelit themelor të gjykatave të Kosovës.



Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesiioni I

Më 01-02 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës, me mbështetjen e GIZ, ka realizuar trajnimin “Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës- Sesiioni I”.

Ky sesion trajnues kishte për qëllim elaborimin e legjislacionit pozitiv, zhvillimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend rreth procedurave dhe fazave të prokurimit publik si dhe identifikimin e indikatorëve të korrupsionit që lidhen me prokurimin publik.

Fillimisht në kuadër të këtij sesiioni trajnues u trajtua legjislacioni primar dhe sekondar që rregullon këtë fushë, ndryshimet legjislative, procedurat e prokurimit publik dhe mënyra e funksionimit të platformës së prokurimit publik elektronik. Në këtë kontekst u elaboruan rregullat për specifikimet teknike dhe dosja e tenderit, përpilimi i dosjes së tenderit, procesi i vlerësimit të një tenderi, si

dhe njoftimi, nënshkrimi dhe ekzekutimi i kontratave publike.

Më tej, trajnimi u fokusua në elaborimin e skemave korruptive dhe problemeve të ndërlidhura me mashtrim, skemat e kurdisjes së ofertave si dhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen e këtyre veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik.

Gjatë fazës së fundit të këtij sesiioni, u diskutua planifikimi i hetimit, përmbajtja e planit të hetimit, ndjekjes, identifikimit të burimeve të informacionit si dhe rëndësia e krijimit të një strukture të hetimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe të apelit.



Aktgjykimi dhe llojet sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore

Më 05 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Ko-



sovës ka organizuar trajnimin për gjyqtarë me temë “Aktgjykimet sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Synim i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në vlerësimin e rrethanave për vendosje të drejtë, zbatimin e drejtë të dispozitave lidhur me marrjen e aktgjykimit në seancë dhe jashtë saj dhe hartimin e arsyetimeve të llojeve të ndryshme të aktgjykimeve.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet si aktgjykimet dhe kushtet për vendosje, llojet e aktgjykimit, përmbajtja e aktgjykimit, marrja e aktgjykimit në seancë dhe jashtë seancës gjyqësore dhe vendosja për aspekte procedurale (llojet e aktvendimeve). Në fokus të trajnimit ishin edhe vlerësimi i fakteve në bazë të provave të administruara në arsyetim të aktgjykimit dhe zbatimi i dispozitave materiale juridike në gjendjen e vërtetuar faktike.

Trajnimi u realizua përmes prezantimeve teorike, analizimit të rasteve studimore dhe diskutimit të problemeve të shfaqura në praktikë. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmisë civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës me theks të veçantë terrorizmin

Më 05-07 prill 2016, IGJK në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV), me mbështetjen projektit të BE-së “Fuqizimi i Kapaciteteve për Hetimin Penal kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit”, ka realizuar trajnimin me temë “Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës me theks të veçantë terrorizmin”.

Trajnimi u përqendrua në elaborimin e veprimeve hetimore, rëndësinë e fazës hetimore policore, hetimit proaktiv dhe reaktiv si forma të grumbullimit të informacioneve në fazën e shkëmbimit të informatave në lidhje me zbulimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale terroriste.

Po ashtu u trajtua edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve në mbledhjen, analizimin e inteligjencës për të identifikuar

me kohë dhe kuptuar kërcënimet terroriste si dhe ngritja e kapaciteteve për reagim dhe hetim të këtyre veprave penale.

Njëkohësisht u diskutua për ngritjen e bashkëpunimit bilateral me vendet fqinje si dhe bashkëpunimin ndërkombëtarë duke përfshirë edhe institucionet relevante ndërkombëtare të zbatimit të ligjit për të përforcuar përpjekjet për shkëmbimin e inteligjencës me qëllim të pengimit apo shkatërrimit të aktiviteteve terroriste brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive, ku përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve, u trajtuan të gjitha dilemat rreth temave në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë si dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.



Përkufizimi i juridiksionit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në raport me gjykatat e rregullta

Më 07 prill 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV, ka realizuar trajnimin me temë “Përkufizimi i juridiksionit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në raport me gjykatat e rregullta”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve me legjislacionin në fuqi e veçmas me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) konkretisht zbërthimin e nenit 4, i cili përcakton si kompetencë ekskluzive fushat që kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të ish AKM-së dhe të AKP-së si dhe mundësia e dërgimit të lëndëve në gjykatat e rregullta sipas nenit 5 të ligjit për DHPGJS-në.

Në këtë trajnim u trajtuan edhe kërkesa të ndryshme për humbje financiare nga këto agjenci, kërkesa kundër një ndërmarrje apo korporate shoqërore, kërkesa që pretendojnë ndonjë të drejtë, titull apo interes për çfarëdo pasurie, apo prone mbi të cilën AKP-ja apo AKM-ja ka, apo ka shpallur autoritetin administrativ, pronësinë e një ndërmarrje dhe pronësinë mbi kapitalin e

ndërmarrjeve shoqërore, të gjitha këto duke u shoqëruar me raste nga praktika.

Gjithanshëm u trajtuan edhe dilemat në praktikë rreth subjekteve që mund të ushtrojnë padi të përcaktuara me nenin 5 të Ligjit për DHPGJS-në. Gjatë trajnimit u dhanë përgjigje edhe në pyetjet si në vijim: nëse pala e paditur nuk bie në përkufizimin e nenit 5 të Ligjit për DHPGJS-në, a duhet të gjykoj DHPGJS-ja apo gjykata e rregullt? Kush mundet me qenë i paditur në DHPGJS? A do të duhej të aplikohet njëkohësisht neni 4 dhe 5 i Ligjit për DHPGJS-në për të kufizuar kompetencën apo të aplikohet ndaras? Trajnimi u fokusua në elaborimin e dilemave të ngritura përmes diskutimeve me pjesëmarrës dhe analizën e problemeve aktuale në praktik.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarë të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe departamenteve të përgjithshme (divizioneve civile) të të gjitha gjykatave themelore.



Trajtimi i kërkesave në procedurën e riorganizimit të ndërmarrjeve shoqërore

Më 08 prill 2015, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV, ka realizuar trajnimin me temë “Trajtimi i kërkesave në procedurën e riorganizimit të ndërmarrjeve shoqërore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me Moratoriumin, Planin e riorganizimit dhe Komitetin e Kreditorëve.

Në fokus ishte riorganizimi që është një procedurë ku shoqëritë tregtare me vështirësi financiare mund të kenë një fillim të freskët dhe një ndihmesë në rimëkëmbjen e tyre. U qartësua se Ligji për AKP-në e parasheh që AKP është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe likuidikimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të ndërmarrjeve shoqërore.

Në këtë trajnim u trajtuan edhe çështja se

kush e nxjerr vendimin për moratorium në riorganizimin e ndërmarrjeve shoqërore? Moratoriumi i përkohshëm a mund të ngrijë veprimet në gjykatat e Kosovës dhe të parandaloj pagesën dhe ekzekutimin e ankesave të kërkuara nga gjykatat jashtë Kosovës kundër ndërmarrjes?

Gjatë këtij trajnimi u aplikuan metoda e shpjegimit të pjesshëm teorik, bashkëbisedimit interaktiv dhe pyetje-përgjigje. Po ashtu u përdor edhe komentimi i dispozitave ligjore që u vlerësua se kanë të meta dhe shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarë të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelor në Prishtinë dhe departamenteve të përgjithshme (divizioneve civile) të të gjitha gjykatave themelore.



Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare

Më 14-15 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës me mbështetjen e UNICEF-it ka realizuar trajnim dy ditor me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore-familjare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët por dhe profesionistët tjerë të përfshirë, të jenë në gjendje që me kompetencë profesionale të zbatojnë standardet më të larta vendore e ndërkombëtare dhe procedurat ku shtrohet nevoja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që fëmijëve tu ofrojnë mbrojtjen e të drejtave sipas parimit të interesit më të mirë për të miturit në çdo rast dhe procedurë.

Trajnimi u fokusua në trajtimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë, në mënyrë specifike sipas Ligjit për Familjen por edhe të akteve tjera normative të rëndësishme, krahasimi me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave

të fëmijëve posaçërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në drejtim të krijimit të praktikave efikase në bazë të cilave duhet të jepet vlerësimi dhe vendimi profesional i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore.

Më tej, u elaborua mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkuro-rëzimit, kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijës, ruajtjes dhe kujdesit ndaj fëmijëve si dhe roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën e besimit të fëmijës.

Po ashtu u shtjellua çështja e alimentacionit, vendosja e kontakteve të fëmijëve me prindërit dhe vendosja e gjykatës për këto raste në mënyrë ex officio.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Kontrata e ndërtimit dhe kontestet rreth saj

Më 19 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kontrata e ndërtimit dhe kontestet rreth saj”.

Në fokus të trajnimit ishin diskutimet rreth aspekteve të përgjithshme nga kontrata e ndërtimit, forma, karakteristikat dhe elementet thelbësore të lidhjes së kontratës, ligji i aplikueshëm tek kontrata e ndërtimit, etj.

Në kuadër të trajnimit u trajtuan edhe detyrimet e kryesit të punimeve të përcaktuara me kontratë, detyrimet e porositësit të punimeve, çmimi i punimeve si dhe procedura gjyqësore në kontestet që

rrjedhin nga kontrata e ndërtimit.

Trajnimi u zhvillua përmes diskutimeve të pjesëmarrësve rreth procedurës së vendosjes nga gjykata në kontestet nga punët ndërtimore, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të deritanishme.

Trajnimi u zhvillua përmes elaborimit të rasteve nga praktika gjyqësore, diskutimeve mbi problemet praktike në vendosje të kontesteve të kontratave të ndërtimit dhe prezantimeve nga trajnuesit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe bashkëpunëtor profesional të nivelit themelor.



Marrja dhe pranueshmëria e provave

Më 18-20 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit “Fuqizimi i Kapaciteteve në hetimet penale kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit” i financuar nga BE, ka realizuar trajnim me temë “Marrja dhe pranueshmëria e provave”.

Ky trajnim kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të akterëve pjesëmarrës gjatë fazës së hetimit dhe gjyqimit lidhur me vlerësimin e provave, me fokus të veçantë në besueshmërinë e dëshmive dhe çështjeve që lidhen me dëshmitë e dëshmitarëve.

Fillimisht në këtë trajnim u elaboruan dëshmitë, metodat e analizës së dëshmive, llojet e dëshmive, duke përfshirë: dokumentet, ekspertët, objektet e inspektimit dhe deklaratat e të pandehurit apo akuzuarit.

Me tej trajnimi u fokusua në dëshmitarët, llojet e tyre, deklaratat dhe shkaqet për

dëshmi të rreme nga ana e tyre. Në këtë kontekst u diskutua lidhur me rolin e dëshmitarit, besueshmërinë e deklaratës së tij si të besueshme apo jo dhe iniciimi i procedurës penale për deklaratë të rrejshme.

Në fazën e fundit të trajnimit u shtjellua marrja në pyetje e dëshmitarëve, teknikat e marrjes në pyetje si dhe rëndësia dhe mënyrat e përgatitjes së dëshmitarit para praktikisht për marrje në pyetje.

Në cilësi të trajnuesit në këtë trajnim ishte një eksperte nga Gjermania, e cila kishte qasje interaktive me pjesëmarrësit duke diskutuar bashkërisht rreth praktikave Gjermane në këtë fushë, dhe duke trajtuar sfidat që hasen në praktikën gjyqësore vendore.

Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.



Pronësia

Më 22 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë përmes projektit “Mbështetje në zbatimin e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut dhe reformën e Institucionit të Ombudspersonit”, ka realizuar trajnimin me temë “Pronësia”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve me legjislacionin në fuqi e veçmas trajtimi i të drejtës së pronësisë dhe mbrojtjes së saj për shkak të problemeve të trashëguara në këtë lëmi. Kjo tematikë ishte me rendësi për gjyqtarët për shkak të ndryshimeve dhe reformave në legjislacion dhe kërkesat që përmbajnë ato.

Gjatë trajnimit u trajtuan mënyra origjinere dhe derivative e fitimit të pronësisë, risitë që sjell Ligji për Pronësinë dhe Drejtat tjera Sendore lidhur me mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë, autorizimet dhe kufizimet e pronarit dhe regjistrimi i të drejtës së

pronësisë, duke u shoqëruar me raste nga praktika gjyqësore.

Gjithanshëm u trajtuan edhe standardet e përcaktuara me Nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të gjitha këto duke u shoqëruar me raste nga praktika e saj në lëmin e pronësisë.

Trajnimi u fokusua edhe në elaborimin e dilemave që paraqiten në praktikën e gjykatave lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë me theks të veçantë lidhur me fitimin e drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues. Me metodat krahasuese u zbërthyen mënyrat derivative dhe origjinere të fitimit të pronësisë sipas ligjit në fuqi dhe akteve tjera ligjore.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të Gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, bashkëpunëtorët profesional në gjykata dhe zyrtarë ligjore nga Zyra e Avokatit të Popullit.



Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit - Sesiioni II

Më 22-23 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës, me mbështetjen e GIZ ka realizuar trajnimin “Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën Kundër Korrupsionit - Sesiioni II”.

Ky sesion trajnimi kishte për synim avancimin e njohurive lidhur me analizat forenzike, ngritjen e shkathtësive për përgatitjen e planeve hetuese në koordinim mes institucioneve relevante në drejtim të luftimit efikas të veprave penale të kësaj natyre.

Fillimisht në kuadër të këtij sesiioni u prezantua struktura, roli dhe funksioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, metodat e saj të punës, mundësitë që ajo ofron gjatë kërkimit të analizave forenzike nga gjyqtarët dhe prokurorët në këtë Agjenci.

Më tej, në këtë sesion u elaborua përdorimi i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit për zbulimin e korrupsionit, llojet, kushtet, personat kompetent për të lëshuar këto masa, përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrave për lëshim të masave si dhe ndihma e organeve tjera për zbatimin e këtyre masave.

Sesiioni trajnues u zhvillua në formë interaktive, ku u diskutua rreth sfidave dhe vështirësive specifike që paraqiten si problematike në praktikë në drejtim të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore dhe luftimit të veprave korruptive.

Përfitues të këtij sesiioni trajnues ishin gjyqtarë të nivelit themelor dhe të apelit dhe prokurorë të nivelit themelor, të cilët kanë vijuar dhe sesiinin e parë të këtij programi.



Luftimi i ekonomisë jo formale

Më 26-28 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit “Fuqizimi i Kapaciteteve për Hetime Penale kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit” ka realizuar trajnimin me temë “Luftimi i ekonomisë jo formale”.

Trajnimi kishte për qëllim avancimin e njohurive lidhur me fenomenet e mashtrimit në ekonomi, trajtimin e metodave efektive për parandalimin e kësaj dukurie dhe thellimin e bashkëpunimit të institucioneve relevante për zbatim të ligjit në këtë fushë.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaborua korniza ligjore që mbulon këtë fushë, hetimet financiare si shtyllë e parë në luftën kundër ekonomisë jo formale, format e këtyre veprave si shpëlarja e parave, shmangia nga tatimi, evazioni fiskal përfshirë kontrabandimin dhe organizimi i

skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm. Më tej u trajtuan mënyrat dhe format e kryerjes së këtyre veprimtarive përmes krimeve kibernetike si dhe veprimet parandaluese për veprat e kësaj natyre.

Trajnimi u realizua me qasje interaktive të ekspertëve gjerman, të angazhuar në këtë trajnim si trajnues dhe pjesëmarrësve të cilët zhvilluan diskutime lidhur me praktikën gjermane dhe krahasimet me praktikën vendore, si dhe ndanë sfidat dhe vështirësitë që paraqitën në luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, zyrtarë policor si dhe zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës Financiare.



Tryezë diskutimi: Mbrojtja e Dëshmitarëve - Sfidat në zbatimin praktik të legjislacionit

Me 26 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Policinë e Kosovës si dhe me mbështetjen e projektit të BE-së WINPRO III të implementuar nga NI*CO, ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temë: “Mbrojtja e Dëshmitarëve - Sfidat në zbatimin praktik të legjislacionit”.

Qëllimi i tryezës ishte diskutimi mbi sfidat, problemet dhe praktikat aktuale në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe rolin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë në zbatimin e këtij programi.

Në fjalën hyrëse U.D. Drejtori i IGJK-së z. Besim Morina, U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale z. Reshat Millaku dhe Sam Black ekspert nga projekti WNIPRO III theksuan rëndësinë e kësaj tryeze e cila synon të shërbej si forum ku do të evidentohej problemet dhe propozohen zgjedhje për eliminimin e paqartësive sa i përket mbrojtjes së dëshmitarëve e në veçanti futjen e dëshmitarëve në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.

Në prezantimet e tyre, Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit z. Lulzim Sylejmani dhe Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve z. Skënder Rrahmani prezantuan për situatën aktuale mbi dëshmitarët në kuadër të Programit mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve. U theksua se Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është plotësisht funksionale dhe posedon teknologjinë e fundit në zbatim të programit, dhe mund të aplikohen të gjitha masat e parapara me ligj.

Pjesëmarrësit në tryezë vlerësuan kapacitetet e Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe theksuan se ky program është tejtejet i rëndësishëm për luftimin e veprave të rënda penale. Gjithashtu, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët u zotuan në inkurajimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për futjen në program.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët, Policia e Kosovës, dhe Shërbimi Korrektues.



Procedura dhe vendimi paraprak në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Më 28 prill 2016, Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të PTV, me mbështetjen e UNDP-së, ka realizuar trajnimin me temë “Procedura dhe Vendimi Paraprak në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thëllimi i njohurive të gjyqtarëve në tematikën se si vihet në lëvizje procedura për vendimin paraprak, cilat çështje mund të adresohen përmes këtij vendimi, cilat janë procedurat para GJDBE-së dhe si vepron gjykata referuese pas marrjes së vendimit paraprak në çështjen e referuar?

Po ashtu u trajtuan edhe efektet e këtyre vendimeve dhe zbatimi i tyre nga gjykatat nacionale si dhe procedura dhe etapat që zhvillohen në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe veçoritë e saja.

Trajnimi u fokusua edhe në elaborimin e

dilemave që paraqiten në praktikën e gjykatave nacionale lidhur me referimin paraprak kur dërgojnë pyetje në GJDBE lidhur me interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian.

Trajnimi ishte në funksion të përgatitjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve me njohuritë e së drejtës evropiane dhe procedurat që zhvillohen në institucionet gjegjëse të BE-së, meqenëse Republika e Kosovës si vend i rrethit juridik-evropian aktualisht është në fazën e procesit integruës evropian ku pos harmonizimit të legjislacionit me standardet e BE-së rëndësi po i kushton reformave në sistemin gjyqësor.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, dhe bashkëpunëtorët profesional.



Aktivitetet Tjera

Lansimi i Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor në Kosovë”

Me 05 prill 2016, u organizua ceremonia e fillimit të Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor në Kosovë”. Përfitues të projektit është Instituti



Gjyqësor i Kosovës ndërsa shtetet partnere janë Gjermania dhe Holanda. Synimi i projektit është të fuqizohet sundimi i ligjit në Kosovë nëpërmjet përmirësimit të arsimit ligjor, në veçanti me rritjen e kapaciteteve në sektorin e drejtësisë duke fuqizuar kapacitetet e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan z. Ymer Hoxha, kryetar i Këshillit Drejtues të IGJK-së, nga zyra e BE-së z. Christoff Stock dhe U.D. Drejtori i IGJK-së z. Besim Morina.

Z. Ymer Hoxha në fjalën e tij mes tjerash tha “ky Projekt i Binjakëzimit është shumë i rëndësishëm për IGJK-në, duke avancuar shërbimet e tij dhe njëherit duke ndihmuar në transformimin në Akademi të Drejtësisë që pritet të ndodh gjatë jetëgjatësisë së këtij Projekti.”

Në fjalën e tij, z. Christoff Stock, potencoi faktin se “ky projekt është ndryshe për faktin se do të përqendrohet në specializimin e

gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit gjyqësor duke ofruar trajnime të përshtatura për nevojat e tyre në punën e përditshme. Duke prezantuar trajnimin e bazuar në kompetenca ky projekt binjakëzimit do të lehtësojë transformimin e IGJK-së në Akademi të Drejtësisë”.

z. Besim Morina theksoi se “me këtë projekt IGJK synon që të fuqizojë edhe më tutje rolin e tij, por edhe të përgatisë infrastrukturën e nevojshme për transformimin në Akademi të Drejtësisë, me qëllim që të vazhdoj mbështetja në zhvillimin e sistemit gjyqësor duke fuqizuar vlerat profesionale, pavarësinë, paanshmërinë dhe efikasitetin e punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë në sistemin gjyqësor në Kosovë.

Projekti u prezantuan nga znj Christine Jacobi – Udhëheqëse e ekipit nga shteti partner i Gjermanisë ndërsa prezantimi në edukimin ligjor u bë nga Eric Vincken – Udhëheqësi i ekipit prej shtetit partner junior Holanda. Rezultatet që priten nga projekti përqendrohen në fuqizimin e sistemit të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë, duke përfshirë edhe kurrikula të reja për trajnim bazuar në kompetencat profesionale.



Punëtori lidhur me hartimin e draft kurrikulës trajnuese të Programit të Trajnimit Fillestar

Më 06 deri 09 prill 2016, IGJK realizoi një punëtori për hartimin e draft rregullore dhe draft kurrikulës trajnuese për Programin e Trajnimit Fillestar.

Mbështetur në ndryshimet legislative, IGJK -së ka vlerësuar se kërkohen ndryshime dhe plotësime të akteve nënligjore të cilat rregullojnë përmbajtjen, kohëzgjatjen e trajnimit teorik dhe praktik dhe të krijoj një sistem për vlerësimin e përmbushjes adekuate të programit trajnues nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, gjatë trajnimit në trajnimit fillestar në IGJK.


Qëllimi i kësaj tryeze ishte përcaktimi i kornizës së draft – kurrikulës trajnuese, identifikimi i nevojave për trajnim/moduleve dhe hartimi i draft rregullore së PTF-së e cila do të rregulloj organizimin e trajnimeve në PTF, të drejtat dhe detyrimet e trajnuesve/mentorëve, raportet e gjyqtarëve/prokurorëve të shtetit të sapo-

emëruar me IGJK-në si dhe kriteret për përfundim të suksesshëm të programit trajnues.

Gjatë kësaj punëtorie përveç draftimit të këtyre akteve është diskutuar edhe për sfidat me të cilat IGJK do të përballlet gjatë zbatimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë dhe prokuror të shtetit të sapoemëruar. Lidhur me këtë çështje janë ofruar ide në lidhje me koordinimin dhe bashkëpunimin me KGJK dhe KPK si dhe përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e rezultateve të trajnimit fillestar.

Si rezultat i kësaj tryeze janë hartuar; draft Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar si dhe draft – kurrikula trajnuese për gjeneratën e gjashtë.

Grupi punues i këtyre akteve ishte stafi i IGJK-së.



Forum “Themelimi i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Evropës Juglindore”

Më 13-14 prill 2016, Këshilli për Bashkëpunim Regjional, GIZ dhe Instituti Nacional i Magjistraturës së Rumanisë organizuan forumin me temë “Themeli i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të vendeve të Evropës Juglindore”.

Në fokus të trajnimit ishte prezantimi i raportit për praktikën më të mirë në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në vendet e anëtare të BE-së dhe Rrjetin e Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor Evropian (EJTN).

Në kuadër të këtij forumi, IGJK prezantoi për kapacitetet institucionale, rolin e saj në

gjyqësor, bashkëpunimin me gjyqtarë dhe prokurorë, anët e forta dhe sfidat, programet vendimmarrjen, praktikën e mirë dhe bashkëpunimin regjional.

Po ashtu në këtë forum në të cilin morën pjesë institucionet e trajnimit gjyqësor të vendeve të Evropës Juglindore, u diskutua dhe u propozuan fushëveprimi i Rrjetit, struktura, roli dhe aktivitetet e tij.

Pjesëmarrës në këtë forum përveç përfaqësuesve të IGJK-së ka marrë pjesë edhe një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.



<https://igjk.rks-gov.net>

Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infokji@rks-gov.net